



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 14669/1 Prot.

Tiranë, më 23 / 12 / 2021

URDHËR

Nr. 240, Datë 23 / 12 / 2021

"PËR  
"PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR MËSIMDHËNËSIT NË ARSIMIN DHE  
FORMIMIN PROFESIONAL, "BAZAT E DIDAKTIKES NË AFP"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 24 neni4 dhe shkronja h, të nenit 7 të ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", shkronjës b të pikës 4 dhe pikës c të kreut II; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 16.10.2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve";

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit të trajnimit për mësimdhënësit në arsimin profesional, "Bazat e didaktikës në arsimin dhe formimin profesional", sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Certifikimi i mësimdhënësve do të bëhet nga Agjencia Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.
3. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit publikë e jopublikë të arsimit dhe formimit profesional.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Delina Ibrahimaj

